

## PROCESVERBAL

Nga seanca e katërt (4) sipas renditjes dhe si e dytë (2) e jashtëzakonshme e kuvendit të komunës së Dragashit, të mbajtur më 25 shkurt 2022, duke filluar nga ora 09:00, me këtë:

### *REND DITE*

- 1. Dhënia e betimit të anëtarit të zëvendësuar nga KQZ-ja z.Edin Kurt**
- 2. Shkarkimi i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës**
- 3. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës**

z.Uran Halimi – Përshëndetje, të nderuar delegatë, kryetar dhe të gjithë të pranishmit. Po e hapi seancën e katërt (4) 2022 me radhë dhe seancën e dytë (2) të jashtëzakonshme, njëkohësisht po e propozoj rendin e ditës që e keni marrë në material (lexon rendin e ditës). A dëshiron dikush të shtojë diçka në lidhje me këtë rend dite?

z.Jetmir Ajdini – Përshëndetje të gjithëve, kam një propozim që ky Rend Dite me të gjitha pikat të mos vazhdojë sot, sepse mendoj se është thirrur nga LDK-ja vetëm për të përmbushur arsyet dhe egon e tyre politike, nuk ka arsye tjetër për të vazhduar me këtë rend dite. Faleminderit.

z.Uran Halimi – A ka ndonjë diskutim për propozimin. Kalojmë në votimin e propozimit të Jetmirit. Kush është që ta miratojë propozimin e Jetmirit dhe ta anulojë rendin e ditës të seancës së sotme. Kush është PRO-13, KUNDËR-, ABSTENIM-0.

z.Samidin Xheladini –Kjo është një seancë e jashtëzakonshme dhe ka pikat e veta të rendit të ditës. Rendi i ditës nuk ndryshon. Procesi duhet të vazhdojë fillimisht me betimin e kandidatit të ri dhe më pas të vazhdojmë me diskutime, propozime e të tjera. Para se gjithash, kandidati i ri duhet të bëjë betimin.

z.Nedžmidin Sejdilar –Të nderuar, betimi nuk mund të bëhet as në seancën e jashtëzakonshme. Është e vërtetë se rendi i ditës nuk ka ndryshuar, por betimet bëhen vetëm në seancat e rregullta.

z.Naser Myrtezani - Përshëndetje të gjithëve, kërkojmë që të vazhdohet me procedurën e rendit të ditës, pasi që e keni thirrur një seancë, ajo duhet të vazhdojë.

z.Uran Halimi – Unë bëj atë që ju kërkon. Më lejoni që të vazhdoj me punën.

z.Jetmir Ajdini –Unë propozova që të mos vazhdohet me këtë rend dite. Të hidhet në votim dhe nëse kemi vota vazhdojmë, nëse nuk kemi, nuk vazhdojmë.

z.Uran Halimi – Vazhdojmë, patëm 13 vota Kundër, kush është Pro? Ngrini duart lart.

z.Sefidin Mejzini - Përshëndetje të gjithëve, duhet të pranojmë që jemi në demokraci, sot shkarkohesh ti, nesër unë këto janë gjëra që ndodhin, gjërat duhen të merren në mënyrë të

relaksuar. Nuk funksionon ashtu siç dëshironi ju. Do të shkarkohesh, nëse jo sot, nesër ose pasnesër.

z.Uran Halimi – Ju duhet ta kuptoni punën time, si në çdo seancë të mëparshme kemi votuar për rendin e ditës, a duhet votuar rendi i ditës?

z.Nedžmidin Sejdlar – Të nderuar kolegë, pajtohem me kolegun tim nga LDK-ja se të gjitha proceset janë demokratike, është gjithashtu një akt demokratik që ka kërkuar që një koleg i VV-së të votojë për rendin e ditës, ndër të tjera. Seancat e jashtëzakonshme dhe seancat e rregullta kanë përmbajtje të njëjtë dhe në të dyja seancat votohet rendi i ditës. Kështu shkruhet në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale. Së dyti, zyrtari ligjor nuk ka të drejtë të na lexojë ligje dhe mësimë këtu. Ne jemi ata që jemi përgjegjës për veprimet tona dhe për votimin ose mosvotimin tonë.

z.Munir Jonuzi - Të nderuar, këtu të gjithë i referohemi Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe duhet t'i referohemi ligjit sepse ky është organ ligjvënës. Unë gjithashtu do ta përdor këtë të drejtë për t'u thirrur në dy ligje, neni 44 pika 3 e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale që thotë se të gjitha pikat e rendit të ditës nuk mund të ndryshohen në seancë të caktuar dhe i referohem asaj që tha kolegu im Nedžmidin se nuk mund të bëhet betimi në një seancë të jashtëzakonshme, i referohem paragrafit 5 i cili thotë se të njëjtat arsye procedurale vlejné si për seancat e jashtëzakonshme ashtu edhe për seancat e rregullta. Nëse delegatët mund të betohen në seancë të rregullt, pse të mos e bëjnë betimin në seancë të jashtëzakonshme.

z.Samidin Xheladini – Në demokraci, ne kemi të drejtë të shqyrtojmë, të debatojmë dhe të japim mendime. Por ne nuk duhet të shkojmë përtej ligjit, sepse ne jemi thirrur këtu për të zbatuar Ligjet. Muniri e përmendi shumë mirë nenin 44, pika 44.3, ku thuhet se pika të caktuara në seancën e jashtëzakonshme nuk ndryshojné gjatë mbledhjes. Nuk kemi të drejtë, nuk mundemi. Ne kemi të drejtën ligjore për të zbatuar këto pika. Se si do të jetë votimi është diçka tjetër.

z.Jetmir Ajdini – Unë nuk kam kërkuar ndryshim të rendit të ditës dhe as ndonjë pikë të rendit të ditës. Unë propozova që të vazhdohet apo jo me këtë rend dite.

z.Uran Halimi – E përsëris, kemi 13 vota për propozimin e Jetmirit për të anuluar këtë rend dite. Pyes kush është kundër propozimit të Jetmirit?

z.Artan Loshaj – Nuk e kuptoj pse kemi ardhur në këtë pikë. Ne e dimë që LDK-ja ishte me nxitim, ka kohë që nuk ka qenë në pushtet. Nuk e di pse keni thirrur një seancë të jashtëzakonshme kur mund të bënit një të rregullt, që kolega të bënte betimin dhe të largoheshit pas kësaj. Që në fillim të mandatit pashë shumë parregullsi, iu përgjigja, në seancën e fundit kur dolëm nga salla, deputeti e ndërpreu seancën për shkak të kuorumit dhe ne nuk e vazhduam, pse nuk reaguat. Në seancën e jashtëzakonshme të datës 18.01.2022, ju që e keni caktuar seancën, të njëjtën e anuloni me SMS. I them kryesuesit, ne kemi të drejtë të propozojmë në rend dite nëse jemi ose jo. Nëse nuk votoni propozimin e Jetmirit, i bëj thirrje opozitës të dalë dhe të shikojmë nëse do të ketë kuorum.

z.Nedžmidin Sejdilar – Plotësisht pajtohem me Munirin, nëse e jashtëzakonshme është njësoj si e rregullta, atëherë votohet edhe rendi i ditës. Ne nuk jemi kundër që delegati të bëjë betimin, por jemi që të hidhet në votim propozimi i z.Jetmir nëse do të kalojë rendi i ditës, nëse nuk ka vota të mjaftueshme, atëherë çfarë të bëjmë.

z.Naser Myrtezani – Nëse dimë të qeverisim është problemi jonë, do ta shohim më vonë. Le ta zgjidhim këtë çështje në mënyrë paqësore, kemi juristin këtu, ai paguhet për këtë, le të japë mendimin e tij nëse kemi të drejtë ose jo. Është shumë e qartë.

z.Uran Halimi – Nuk kemi nevojë për shpjegime, mendoj se ndjekim procedurat e rregullta të zhvillimit të një seance. Nëse nuk mund të vazhdohet, unë ju bëj thirrje delegatëve të opozitës ta lëshojnë seancën.

z.Nedžmidin Sejdilar – Largimi nga seanca është gabim, sepse do të vijë Muniri, do ta udhëheqë seancën dhe do të japë mundësinë e betimit. Nuk ka dalje nga seanca, ne votojmë ose nuk e votojmë rendin e ditës. Sa i përket juristit, nëse ai e merr fjalën, atëherë mund ta marrin fjalën edhe ata që na shikojnë. Nuk ka të drejtë të flasë këtu, as të këshillojë kryesuesin pa e pyetur ai.

z.Sefidin Mejzini – Mund ta shtyni sot, por do të vazhdojë javën tjetër. Kjo është një punë e kryer. Këto janë disa iniciativa që nuk po na çojnë askund. Që në ditën e parë e pasë që kryesuesi nuk ishte kryesuesi i kuvendit por i partisë. Për mendimin tim, ai meriton vendin më të vogël nga ne të 27. Kjo është e vërtetë. Kështu e nisët që nga dita e parë. Për 4 vite, kemi lëshuar seancën vetëm një herë. Ju duhet të përshtateni me faktin që ne jemi në pozitë tani. Ne kemi mësuar për 4 vjet dhe ja ku jemi tani, dhe juve ju duhet një servis për 8 vjet që të ktheheni, por në këtë mënyrë nuk është në rregull.

z.Munir Jonuzi – Lidhur me seancë të mbajtur më 13.01.2022 dhe në të cilin kam përdorur termin të gabuar “ndërprerje” për të cilin kam kërkuar falje në kuvendin e kaluar dhe në të cilin kam shpjeguar arsyet, shoh që Artani e përmend sërish, andaj mund t’i përgjigjem. . Koleg, nëse nuk ka kuorum në kuvend mbyllet automatikisht dhe nuk mund të vazhdojë, ajo është e mbyllur. Sapo nuk ka kuorum Kuvendi nuk mund të vazhdojë dhe mbyllet. Tani një këshill për kryesuesin, do t’i kërkoja që të respektojë Rregulloren e Kuvendit, sipas së cilës secili prej nesh ka të drejtë të shprehë mendimin e tij për një debat apo diskutim vetëm një herë. Këtu shohim delegatë që dalin 15 herë. Ne delegatët kemi të drejtë të shprehim mendimin tonë për një debat apo diskutim vetëm një herë, dhe mundësisht një përgjigje prej 2 minutash. Unë iu referova dy ligjeve dhe shikoni ndaras, nuk guxon të ndryshohet rendi i ditës së seancës së jashtëzakonshme. Në momentin që nuk guxon të ndryshohet, i drejtohem pikave të rendit të ditës së Kuvendit të Jashtëzakonshëm, zbatohet paragrafi i dytë i ligjit, i cili thotë: të njëjtat arsye procedurale vlejnë për kuvendet e rregullta dhe të vlefshme për kuvendet e jashtëzakonshme. Shikoni dy ligjet e ndara ashtu siç duhet t’i shikoni ato.

z.Uran Halimi – A duhet të votojmë për rendin e ditës? A duhet të votojmë për çdo propozim të delegatëve?

z.Munir Jonuzi – Unë e kam shprehur mendimin tim, nuk jam jurist dhe nuk mund ta interpretoj Ligjin, e kam shprehur mendimin tim në bazë të asaj që kam lexuar në nenet e Ligjit që duhet të respektojmë dhe zbatojmë. Ky është vetëm një mendim. Nuk e di nëse është e drejtë apo jo, nuk jam jurist.

z.Arjeta Skeraj – Përshëndetje të gjithëve, kemi arritur në këtë pikë ku nuk e di as ku jemi dhe çfarë jemi. Së pari as kryesuesi nuk e di, më vjen keq për delegatët dhe kryesuesin, ai ngre dorën tre herë dhe flet tre herë, a ka të drejtë të ngrejë dorën disa herë dhe të marrë fjalën, pyes kryesuesin. Unë kërkoj një pushim prej 10 minuta për t'u konsultuar me ekspertët, ose ne si delegatë nuk e dimë ose ju kryesues nuk dini, ose të dyja, le ta zgjidhim këtë së bashku dhe të shohim nëse duhet hequr apo jo. Le të bëjmë një pushim dhe të vërtetohuni nëse je i sigurt nëse do ta heqësh apo jo.

z.Uran Halimi – Kush doli tre herë në foltore?

z.Arjeta Skeraj – z.Nedzmidin, delegatit i jepet fjala disa herë vetëm nëse i përmendet emri.

z.Shpetim Hajredini – Në seancën e kaluar, e theksova se nuk kemi kohë për të humbur dhe për t'u marrë me emërime apo shkarkime të pushtetit ekzekutiv. z.Nedzmidin është kreu i grupit të tij parlamentar. PDK-ja ka shefin e saj të grupit parlamentar. Pra, ai ka të drejtë të marrë fjalën sa herë e lejon ligji dhe kryesuesi. Nuk e di pse përmendet si shef i grupit parlamentar të PDK-së. Unë jam shef i grupit parlamentar. Ne kemi grupin tonë. Ne kemi të drejtën për të votuar apo jo. Në momentin kur votohet rendi i ditës nuk ka ndryshim sepse ka seancë të jashtëzakonshme. Por, rendi i ditës duhet të votohet edhe në seancë të jashtëzakonshme. Kërkesa është paraqitur nga një delegat që ka vota dhe që është legjitim. Në atë pikë, ne duhet të votojmë nëse jemi pro apo kundër rendit të ditës.

z.Nedzmidin Sejdilar – Nuk e di pse po i diskutojmë këto gjëra. Është shumë e thjeshtë. Secili prej nesh ka të drejtë të vendosë diçka në votim. Ai propozim kalon ose nuk kalon, shumë e thjesht. As nuk shkelet ligji, Muniri tha shumë mirë se seancat e rregullta dhe të jashtëzakonshme nuk kanë dallime përveç rendit të ditës, e cila nuk ndryshon. Pra, le të votojmë propozimin e kolegut, të kalojë ose jo, shumë e thjesht. Nuk kemi faj që ju keni një votë deficit. Zonja dhe zotërinj, jam i të njëjtit mendim me Jetmirin dhe në emër të grupit tim parlamentar, kërkoj që rendi i ditës të hidhet në votim.

z.Nexhat Selaj – Përshëndetje të gjithëve, unë nuk vij nga fusha e akuzave, por jam i detyruar të flas pak nga aspekti i akuzave. Mua nuk më takon që të akuzojë nga aspekti i profesorit, deri më tani kam qenë në pritje të urdhrin për të filluar zbatimin e programit dhe të gjitha atyre që i ka paraqitur LDK-ja gjatë fushatës dhe mezi pres të punojmë së bashku në interesin e qytetarëve. Për ta ndjerë popullata dhe votuesit koalicionin e “shpresës”, ju u thirrët si koalicioni shpresës dhe për pak sa nuk u “martuat”. Ju përmendët ligjet në praninë

tonë, Urani është votuar si kryesues, tani është duke u shkarkuar. Le të shohë popullata se kush është koalicioni i shpresës. Kam dëgjuar se është thënë se LDK-ja e ka lënë seancën vetëm një herë në 14 vjet në opozitë, që është për duartrokitje, pse, sepse nuk e ka sjellë veten në pozitë që dikush ta lë seancën. Këto komplikime i krijoni vetë. Një seancë e jashtëzakonshme 3 javë më parë, e planifikuar nga ana e Kryetarit dhe Kryesuesit, na keni lënë para derës së Kuvendit. E keni planifikuar vetë dhe po na njoftoni me SMS se takimi nis për një ditë tjetër. Tani përsëri një seancë e jashtëzakonshme. Mendoj, sipas mendimit tim personal, pa koordinim me kolegët e partisë, që në seancën e radhës të kemi në rendin e ditës Betimin e Delegatit të Ri dhe do të vazhdojmë më vonë me pikat e tjera të rendit të ditës. Dhe le t'i japim fund këtij kaosi. Nuk mendoj se kemi kohë, kanë kaluar 4 muaj, do t'i jap përkrahje të plotë LDK-së, që të ndihmoj sa më shumë për projektin që e ka premtuar me shpresë se do t'i realizojë.

z.Naser Myrtezani – I drejtohem kolegut si delegat dhe si koleg profesor, me ke fyer kur ke thënë "martesë", kujdes në debate se janë debate zyrtare, të kërkoj falje nëse gaboj. Nëse i referohemi edukimit të brezave, duke pasur parasysh popullsinë femërore, nuk na takon neve të përdorim terma të tillë në aspektin politik.

z.Nexhat Selaj – Fjala “martesë” ka qenë në aspektin politik, ndërsa sa i përket aspektit moral, falë Zotit jemi të gjithë të pastër dhe lutem që të jemi të tillë. E përdora atë termin në aspektin politik, ju vetëm e dini që koalicioni i shpresës ju ka sjellë në këtë gjendje që jemi sot. Kërkoj transparencë mes atij Koalicioni të Shpresës, delegatët e juaj kërkojnë që t'ju mbështesim, ju gjithmonë do të keni mbështetjen por jo mbështetjen që na sollti në këtë situatë dhe tani ju kërkoni ndihmë. Do të merrni mbështetje për realizimin e të gjitha projekteve që do të jenë në interes të qytetarëve. Ndërsa këto akuza me të cilat na keni sjellë në këtë situatë, tashmë 5 seanca, këta jeni ju nuk jemi ne, nuk e di se çfarë ndihme po na kërkoni për t'ju favorizuar për sa i përket rregullimit të organeve tuaja të brendshme.

z.Uran Halimi – Mendoj se duhet të kthehem aty ku e lamë, propozimi i delegatit të Jetmirit, patëm 13 vota Pro kush është kundër propozimit të Jetmir Ajdinit?

z.Munir Jonuzi – Ky nuk është delegati i parë që bën betimin në këtë mandat, të shohim si kemi punuar deri tani. Kemi video inçizimet, bëjmë një pushim 10 minuta, shikojmë inçizimet, a kanë bërë betimin fillimisht delegatët dhe më pas a është votuar rendi i ditës apo anasjelltas. Le të shohim pamjet se si kemi punuar deri tani. Ky është kod i praktikës së mirë. Deri më tani askush nuk ka pasur ndonjë vërejtje për këtë, të shohim se si ka qenë në Kuvend në seancën 3, me datë 08/02/2022, nëse delegatët kanë dhënë fillimisht betimin dhe pastaj kemi votuar për rendin e ditës. Nëse po, atëherë le të vazhdojmë tani. Kjo është një zgjidhje. Për mendimin tim, kur bën betimin në një kuvend të caktuar, fillimisht bën betimin, ta përfundojmë atë pjesë dhe pastaj të kalojmë në votimin e rendit të ditës dhe çdo gjë tjetër që pason në atë seancë të kuvendit.

z.Uran Halimi – Ju faleminderit, ne fillimisht e kemi vënë rendin e ditës në votim dhe më pas kemi vazhduar me seancën dhe pikat një nga një.

z.Samidin Xheladini – Munir faleminderit për orientimin, unë dhe Arjeta jemi tashmë 4 mandate, të tjerët më pak, delegati gjithmonë edhe në Kuvendin e Kosovës fillimisht bën betimin e pastaj vazhdon me rendin e ditës. Është mirë që sot ta mbyllim këtë seancë dhe të vazhdojmë me seancën e radhës, sepse në seancat e ardhshme, por unë gjithmonë kam kërkuar nga ekzekutivi që të mos na mbledhë material, sepse në seancën e ardhshme do të kemi material të gjerë që shumica dërrmuese e delegatëve nuk do të jenë në gjendje ta lexojnë, e jo më të debatojë apo ta analizojë. Prandaj jam duke kërkuar seanca produktive, të cilat do të jenë në nivel dhe në të cilat delegatët do të mund të japin kontributin e tyre. Sepse kur kemi material të gjerë, është shumë e vështirë të zgjidhim problemet. Jam dakord kur profesori i nderuar tha se duhet punuar dhe orientuar qeverinë në rrugën e duhur. Në seancën e ardhshme do të shihni se do të duhen 10 orë debat. Hidhni një sy inçizimeve, fillimisht bëhet betimi dhe më pas vazhdon puna.

z.Uran Halimi – Kërkoj mirëkuptim që kjo seancë të mbahet siç duhet, vetëm kërkoj të zhvillohet normalisht, ju lutem mos më bllokoni, kemi pasur 13 vota pro, kush është kundër propozimit të Jetmir Ajdinit? Asnjë kundërshtim, asnjë abstenim. Atëherë do t'ju konsideroj si të padeklaruar në këtë votim. Andaj e deklaroj të mbyllur këtë seancë. Faleminderit.

**Përgatiti:**

**Shërbimi i Kuvendit**

**Kryesues:**

**Uran Halimi**